



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE**

Titulli i Modullit : E-Komunikim

Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Frëngjisht

Kohëzgjatja e programit të modullit: 40 orë

Nr. i krediteve: 4 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Nëpërmjet metodave mësimore aktive dhe pjesëmarrëse, skenareve edukative duke përdorur mjete digjitale dhe platforma interaktive të tilla si Kahoot, Mentimeter.

PËRMBLEDHJE E MODULLIT:

Ky modul formimi është hartuar mbi nevojën e tregut aktual të punës për profesionistë në fushën e turizmit me njohuri dhe aftësi që do t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë komunikimin dhe marrëdhëniet me klientët në një botë gjithnjë e më digjitale.

Në një epokë digjitale, e-komunikimi është një domosdoshmëri për çdo insitucion. Klientët e sotëm kërkojnë informacion të shpejtë dhe efikas, dhe përdorimi i mjeteve elektronike është mënyra kryesore për të arritur këtë. Njohja dhe përvetësimi i këtyre mjeteve ndihmon në rritjen e efikasitetit të komunikimit dhe në përmirësimin e shërbimit ndaj klientëve. Komunikimi elektronik dhe rëndësia e tij në sektorin e turizmit është thelbësor për të kuptuar kontekstin në të cilin operon kjo industri. E-komunikimi lehtëson shkëmbimin e informacionit në kohë reale, rrit transparencën dhe ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të forta me klientët.

Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njohin mjete të ndryshme të komunikimit, përfshirë emailin, mesazhet e çastit, rrjetet sociale dhe blogjet.

Ky modul do t'i vijë në ndihmë pjesëmarrësve të aplikojnë njohuritë e marra përmes ushtrimeve praktike, workshop-eve, aktivitete që do t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi të konkretizuara në krijimin e përmbytjeve, menaxhimin e komunikimeve dhe optimizimin e strategjive të

marketingut dhe të krijojnë strategji efektive për rrjetet sociale dhe internet.

REZULTATET E TË NXËNIT:

- Përvetësimi i mjeteve të komunikimit elektronik;
- Përmirësimi i komunikimit me klientët;
- Krijimi dhe menaxhimi i përmbajtjeve online;
- Optimizimi i pranisw në internet;
- Njohja me strategjitë për të përmirësuar shikueshmërinë në internet;
- Menaxhimi i komenteve të klientëve në platforma të ndryshme.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

- Të përvetësohen mjetet e komunikimit elektronik; (8 orë)
- Të përmirësohet i komunikimit me klientët; (8 orë)
- Të krijohen dhe menaxhohen përmbajtje online; (8 orë)
- Të optimizohet prania në internet; (8 orë)
- Të njihen strategjitë për të përmirësuar shikueshmërinë në internet; (8 orë)
- Të menaxhohen komentet e klientëve në platforma të ndryshme. (8 orë)